

Të përgjithshme

Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM), gjatë vitit 2016 ka punuar simbas programit të miratuar, të hartuar në mbështetje të kuadrit ligjor për sigurinë e digave e dambave në vend. Ka marrë në shqyrtim projektet e paraqitura, ka ndjekur propozimet e bëra për rastet që ka qenë e nevojshme të bëhen studime për saktësim të gjëndjes, si dhe ka marrë pjesë në grupet e hartimit të procedurave për programet e venies për herë të parë në ngarkesë të objekteve të reja.

KKDM ka vazhduar të detajojë dhe adaptojë në kushtet reale, propozimin për hartimin e zbatimin e një programi kombëtar për sigurinë e digave.

I. Ndër aktivitetet kryesore gjatë vitit 2016 kanë qenë :

- Shqyrtimi i Planit të Përmbytjeve për hidrocentralin e Banjës, projekti hidroenergjitik i Lumit Devoll.
- Miratimi i dokumentacionit dhe dhënia e Autorizimit për mbushjen për herë të parë të rezervuarit të hidrocentralit të Banjës me Vendimin e KKDM nr.1 dt. 15.04.2016.
- Shqyrtimi dhe miratimi i projektit të zbatimit të digës për ndërtimin e HEC Lumzi - Pukë.
- Eshtë bërë shqyrtimi i materialeve që lidhen me monitorimin e filtrimeve në digën e Komanit, të relatuar nga KESH-i.
- Me rastin e reformës territoriale dhe transferimit të digave nga MZHRAU në Bashkitë (VKM nr. 1108 dt. 30.12.2015), KKDM në bashkëpunim dhe me STKKU kanë organizuar Konferencën Kombëtare për kuptimin e “Sigurisë së Digave” me pjesmarrjen e përgjegjësve kryesorë të bashkive dhe ministrive përkatëse.
- Eshtë shqyrtuar dhe marrë vendim për projektin e Riparimit të Digës së Ragamit të paraqitur nga KESH-i.
- Shqyrtuar e miratuar projekt zbatimi i rrëshqitjes në digën e Divjakës, etj.
- Janë bërë vazhdimisht në kohë kujtesat e kërkesave të rregullores së sigurisë së digave në organet që kanë në përdorim e shfrytëzim diga në vend.
- Brenda mundësive janë ndjekur në vend dhe cështje të cilat kanë patur nevojë për një ekspertizë me të lartë teknike, (Argjinatura Cermë-Lushnjë, etj).

- Nga anëtarët e KKDM dhe KTDM është marrë pjesë në cdo aktivitet që ka qenë e nevojshme për të sqaruar rëndësinë e marrjes në konsideratë të problemeve që kanë të bëjnë me sigurinë e digave në vend.

II. Digat në sektorin e Bujqësisë.

Këtu kemi dy grupe, shtatë digat me kryesore që administrohen nga MBZHRAU dhe mbi 600 digat që administrohen nga Bashkitë.

Digat që administrohen nga MBZHRAU:

Mendojmë se për specialistët e kësaj ministrie (në qendër e në borde) nuk është problem mbajtja nën kontroll e sigurisë së këtyre shtatë digave (Belesova- Berat, Bllaca- Dibër, Doftia- Gjirokastrë, Gjanci- Korçë, Janjar-Sarandë, Shtodër-Shkodër e Muriz-Thanë në Lushnjë). Këto janë diga me karakteristika të mira dhe specialistët e kësaj ministrie kanë trashëguar eksperiencën e shumë dhjetëvjeçarëve në këtë aspekt. Nuk pretendohet që në këto diga të mos ketë probleme por konsiderohet se janë probleme që institucionet përkatëse kanë të gjitha mjetet për ti mbajtur nën kontroll në aspektin e sigurisë së tyre.

Digat që administrohen nga Bashkitë :

Në zbatim të VKM nr. 1108, datë. 30.12. 2015, për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave të Bashkitë të Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, gjatë vitit 2016 është bërë dokumentacioni për realizimin e këtij vendimi.

Lista e digave të rezervuarëve të sistemit të bujqësisë ka qenë 682 diga sipas vendimit lartpërmendur transferohen 540 diga.

- Gjatë vitit 2016 janë transferuar plotësisht 470 diga me dokumentacionin përkatës dhe aktualisht janë në proces transferimi gjatë vitit 2017, 70 diga të rezervuarëve në bashkitë Tiranë , Vorë, Kamëz dhe Pukë.
- 7 diga të rezervuarëve kryesor janë mbajtur nën/administrim nga Ministria e Bujqësisë.
- Vëmë në dukje se 132 diga kanë qenë nën/administrim të Njësive Vendore sipas VKM nr.567.datë 14.07.2010 “Për Transferimin e rezervuarëve dhe skemave ujitëse përkatëse nga MBUMK në pronësi të qeverisjes së njësive vendore”.

Nga Ministria e Bujqësisë janë marrë masa duke dhënë asistencë teknike që pranë Bordeve Rajonale të Kullimit të ngrihen Njësiti Teknike të Digave.

Në këtë kuadër nga kjo ministri me financim të Bankës Botërore u organizua seminari për shërbim e trajnim të personelit teknik të digave pranë bordeve të kullimit me temë “Mirëmbajtja e digave dhe mbrojtja nga përmbytjet”.

Në ministri funksionon sektori teknik, i cili përgjigjet për sigurinë e digave pranë Drejtorisë së Përgjithëshme të Administrimit të Ujrave dhe Tokës.

Nga raportet-vjetore për digat që kanë në administrim të dërguara nga Bashkitë për vitin 2016 rezulton se në pjesën më të madhe të tyre ato kanë probleme të ndryshme ndër të cilat më kryesore janë si më poshtë.

- Në shumë diga ka carje dhe rrëshqitje, deformime, cedime dhe filtrime si në atë të rezervuarit të Thumanës Kurjë, Xhafzotaj, Romanat e Arapaj 1, Durrës: Rog, Zhepe, Qafë në Skrapar, Malinë Pogradec, Likeshit, Gjipalaj e Rubjesës në Shijak etj .
- Ujëlëshuesit e rezervuarëve në shumë raste janë jashtë funksionit, carje të tubacioneve dhe dëmtime të saracineskave të poshtme, mbushje e prishje pusetash si p.sh në digat e rezervuarëve të Granës, LLukanit Qafë Mures Vakufit-Dibër të Metallajt, Cizmelisë Shijak, të Lumarit 1&2, Coreshit 2, të Godurvës e Gjynaqares në Mallakastër, të Dukajt, Gusmarit e Revarit në Tepelenë, të Kumonës, Perlatit e Tarazhit në Mirditë etj.
- Në disa rezervuarë ka problem me shkarkuesit si në digat e rezervuarëve të Barces e Arapaj 2 në Durrës, Maqellarës e Melanit Dibër, Likeshit dhe Cezmelisë Shijak etj.
- Në disa rezervuare ka filtrime në kupë të rezervuarit si në atë të Corushit 2 Mallakastër.
- Shumë rezervuarë janë mbushur me aluvione pjesërisht ose plotësisht dhe janë jashtë funksionit.
- Për shumë raste nga bashkitë si ajo e Vlorës e Skraparit dhe Pogradecit është kërkuar asistencë e specializuar për trajtimin e fenomeneve dhe problemeve që kanë digat dhe për eliminimin e tyre.

Në këto kushte është e nevojshme që nga Ministria e Bujqësisë të caktohet një grup specialistësh të kualifikuar për të parë gjëndjen e digave dhe rezervuarëve i cili të evidentojë problemet, të përcaktojë përafërsisht masat

që duhet të merren për riparimin e tyre së bashku me kushtimin e përafërt të punimeve të nevojshme.

- Po ashtu ky grup duhet të përcaktojë, se cilët rezervuarë duhet të hiqen direkt nga lista e digave si dhe cilët duhen të hiqen mbasi të merren masat përkatëse në varësi të kushteve që ndodhet rezervuari.
- Në cdo Bashki Njësitë teknike të digave të sistemojnë dokumentacionin për cdo digë ku të përfshihet projekti dhe cdo relacion i hartuar, për ato diga që nuk ka projekte të hartohen projektet sipas gjëndjes ekzistuese.

Po ashtu nga Bashkitë të hartohet për cdo digë harta e përmbytjeve në rastet e prishjes së digës dhe planet e alarmit dhe evakuimit për popullsinë që ndodhet poshtë saj.

Digat e Bashkisë Tiranë:

Këto po i trajtojmë me vete për një arsye, mbasi janë në zona shumë të populluara dhe dy më të rëndësishmet prej tyre, Bovilla dhe ajo e Liqenit Artificial, pavarisht se janë në pronësi të Bashkisë Tiranë, ato administrohen nga Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve Tiranë.

Nga digat për qëllime ujitje janë rreth 48 të tilla. Ato janë të gjitha të ndërtuara që në vitet shtatëdhjetë dhe kanë vuajtur të gjitha problemet e tranzicionit si në aspektin e mungesës së fondeve për investim e riparime, ashtu dhe në aspektin e ndryshimeve organizativo administrative të menaxhimit të tyre. Ka qenë shume efektiv menaxhimi nga Drejtoritë e Ujrave (në aspektin e sigurisë dhe ndjekjes së problematikës) dhe kanë rezultuar jo të tilla me bordet, shoqatat dhe transferimet e ndryshme. Nga ana e bashkisë me të drejtë shume herë është marë masa e uljes së nivelit të ujit për të mënjeluar riskun dhe brenda mundësive janë bërë ndërhyrje pjesore nga ato më të domosdoshmet si për riparimin e saracineskave të shkarkuesve fundorë për të pasur mundësi manovrimi. Më me problem sa për ti përmendur janë digat: Tufinë, Zall Herr, Farkë, etj.,

Diga e Bovillës.

Admnistrohet nga Ujësjellës Kanalizime sh.a Tiranë.

Mund të themi se Njësia e Drejtimit Teknik të kësaj dige, kryen me cilësi monitorimin e gjëndjes së saj. Vazhdimisht janë pasqyruar të dhënat e treguesve të digës si dhe vrojtimeve vizuale të brigjeve të rezervuarit.

Diga e Bovillës rezulton se nuk ka problem në drejtim të filtrimeve, cedimeve veprave ndihmëse si dhe mekanizmave të manovrimit.

Problem serioz për këtë digë është mungesa e studimit të përhapjes së valës nga rezervuari i Bovillës si për rastin e shkarkimeve maximale ashtu edhe të një avarie të mundshme të digës.

KKDM ka rikujtuar vazhdimisht dhe ka kërkuar nga Ndërmarrja e Ujësjiellës Kanalizime Tiranë që të hartojë studimin e përhapjes së valës si dhe Planin e Alarmit dhe Evakuimit për Bovillën (shkresat nr.34 datë 9.06.2016, nr.54 datë 11.10 2016). Deri më sot kjo kërkesë ligjore nuk është plotësuar nga ndërmarrja Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë.

Përmendim se me ndryshimin e gjëndjes (lëvizjet demografike dhe ndërtimet) në anën e poshtme të digës, bëhet vazhdimisht më e nevojshme bërja dhe implementimi i një plani alarmi dhe evakuimi për popullatën. KKDM do të ritheksojë dhe një herë kërkesat për përmbushjen e këtij detyrimi.

Diga e Liqenit Artificial të Tiranës.

Administrohet nga Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Tiranë

Diga vazhdon të mbarti një pjesë të problematikave të vërejtura në vite.

Diga është ndërtuar në vitet 1958- 1962, ka lartësi 17 m dhe rezervuar me volum 2.6 milion m³ ujë.

Ndër vite ka pasur problem qëndrueshmëria në skarpatat e saj si në atë të brendshme (më e madhja ajo e vitit 1968) po ashtu edhe në skarpatën e jashtme.

Në vitin 1999 u ristudjua dhe u rikostruktua me projekt të ISP Hidroteknike.

Në vitin 2002 ndodhi bllokimi i portave të shkarkuesit fundor.

Sipas informacionit vjetor të dërguar nga ndërmarrja UKTiranë rezulton se janë evidente problemet e mëposhtme:

- Kostatohen deformime në anën e sipërme të digës.
- Vazhdojnë të jenë të bllokuara portat e shkarkuesit fundor.
- Nuk janë kryer matje në puset pjezometrike dhe në pikat fikse gjeodezike.
- Nuk po kryhen matje të filtrimeve në pikat e kontrollit të anës së jashtme.
- Kanali i largimit të ujrave nga diga në Lanë është po në gjëndjen e mëparshme, pra i pa kontrolluar për aftësinë transportuese të tij.

KKDM thekson se Diga e Liqenit Artificial të Tiranës duhet medoemos të trajtohet për të ardhur në parametrat e funksionimit dhe sigurisë që duhet të kishte nga projekti, si dhe ato që kërkon koha.

Për këtë digë është e detyrueshme që:

- *Të bëhet studimi i përhapjes së valës nga liqeni (konform kërkesave ligjore) si dhe të kompletohet me planin e alarmit dhe evakuimit. Këto plane pasi të hartohen dhe të miratohen duhet të punohet për implementimin e tyre.*
- *Të bëhet studimi dhe të hartohet projekt-zbatimi i rehabilitimit të plotë të shkarkuesit(të plotave dhe atij fundor) për të qenë në gadishmëri si në rast të fenomeneve natyrore dhe në raste defektesh e avarish në vetë digën. Në këtë studim duhet të përfshihet dhe vetë gjëndja e trupit të digës.*
- *Të kontrollohet e të studiohet dhe projektohet nevoja e ndërhyrjes për përmirësim të kanalit të shkarkimit nga diga në lumin e Lanës.*

Për të gjitha sa më sipër KKDM-ja i është drejtuar zyrtarisht, gjatë vitit 2016, Bashkisë Tiranë dhe ndërmarrjes UK Tiranë si pronar dhe përdorues së Liqenit Artificial të Tiranës. Vërejmë (nga raporti vjetor i tyre) se është punuar shumë pak në këtë drejtim.

Theksojmë se puna e mirë që bëhet nga njësia e drejtimit teknik të rezervuarit të Bovillës duhet të gjejë vend dhe të implementohet dhe në atë të Liqenit Artificial të Tiranës.

KKDM-ja impenjohet që të vazhdojë kërkesat dhe të japë ndihmesën e duhur në Bashkinë e Tiranës, për plotësimin e kushteve për sjelljen e shfrytëzimit të digës ne parametrat teknik, por theksojmë se pa impenjimin dhe financimin e pronarit dhe shfrytëzuesit nuk mund të arrihet asgjë. KKDM nuk ka fuqi më të medhaja se sa të vlerësojë dhe të japë mendimin e saj mbi problemin.

III. Digat e kaskadës së Lumit Drin të administruara nga KESH-sha.

Pesë digat e tre HEC-eve më të mëdhej në vend, krijojnë dhe rezervuaret me të mëdhej me një volum prej 3,8 miliarde m³. Rëndësia e tyre vlerësohet për energjinë e prodhuar, volumin e ujit të depozituar e përpunuar, por dhe për sigurinë që duhet të garantojnë për funksionimin normal të tyre.

Nga matjet e vrojtimit e kryera dhe nga materialet e paraqitura nga KESH sh a gjëndja e këtyre digave qëndron si më poshtë:

Diga e Fierzës, me lartësi 167m, është ndërtuar në vitin 1978. Kjo digë vazhdon të kryej me sukses qëllimin e ndërtimit të saj duke mos patur problem lidhur me qëndrueshmërinë e saj. Gjatë vitit 2016, janë kryer rregullisht regjistrimi i të

dhënave të monitorimit si dhe interpretimi i tyre. Monitorimi i prurjeve, ai gjeodezik, sizmik dhe i filtrimeve, ka pasqyruar gjëndjen e shëndetëshme të digës. Me rëndësi të vecantë është treguesi i matjeve të nivelit të ujrave nëntokësorë në anën e poshtme të digës i cili ka qenë brënda parametrave dhe i pa ndikuar nga lëvizjet e nivelit të ujit në anën e sipërme të digës. Element tjetër i sigurisë për këtë vepër është gjëndja e masivit të Poravës. Nga monitorimi gjeodezik, gjeologjik dhe i nivelit të ujrave, ka rezultuar se nuk evidentohen lëvizje të masivit dhe as influencime nga luhatjet e nivelit të ujit në liqenin e Fierzës.

Përmendim se nga shoqëria KESH-sha, janë kryer dhe një sërë punimesh për mirëmbajtjen me projekt zbatimin përkatës si dhe studime të gjykuara të nevojshme nga pronari e shfrytëzuesi i saj. Kështu janë kryer punime rehabilitimi në tunelin 4, kompletim i sistemit të monitorimit të masivit të Gropajve si dhe punime betoni në pusin e shuarjes dhe rymëshpejtuesit të HEC-it Fierzë.

Gjëndja e portës së Tunelit 3 ngelet po ajo e mëparshme. Kjo portë nuk është hapur që prej vitit 1990. Edhe në raportin e vitit 2015, KKDM ka rekomanduar që KESH-Sha duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për gjetjen e zgjidhjes për mundësite e manovrimit të kësaj porte, sepse hapja dhe mbyllja e kësaj porte do të garantojë qëndrueshmërinë e digës për rastin e prurjeve të mëdha e të jashtëzakonshme. Sa më shumë kohë që kalon aq më i vështirë do jetë zgjidhja e problemit.

Diga e Komanit, me lartësi 133 m, është ndërtuar në vitin 1985. Është digë e ndërtuar me gurë dhe me ekran betonarme. Kjo digë është e mbështetur në formacione shkëmbore dhe në shpate e bazament ka një perde cimentimi kundrafiltrimi me gjatësi 700 m dhe thellësi maksimale 156 m.

Gjatë vitit 2016 përfundoi zbatimi i projektit për rehabilitimin e anës së poshtme të digës së Komanit. Ky projekt është realizuar me financim të Bankës Botërore.

Përmendim me preokupim se vazhdon gjëndja e filtrimeve në anën e poshtme të digës dhe në të njejtën sasi si dhe në vitin 2015, kur u evidentua për herë të parë. KKDM ka rekomanduar që të mbahet gjëndja e filtrimeve nën kontroll në aspektin e monitorimit si sasi dhe si turbullsi dhe gjithashtu ka rekomanduar marrjen e masave nga KESH-sha për rakordimin e veprimeve me mundësinë e uljes së nivelit në anën e sipërme, deri në atë minimal të lejuar, për të mënjanuar një pjesë të mirë të dyshimeve për filtrim. KKDM gjithashtu ka parashikuar në programin e saj për 2017 që të marrë në analizë dhe një herë raportin e filtrimeve në anën e poshtme të kësaj dige, mbas punimeve të rehabilitimit me anën e poshtëme. Theksojmë se për shkak të këtyre filtrimeve dhe monitorimi i pjesës tjetër të digës merr një rëndësi të vecantë për vrojtimin e ndonjë fenomeni të pa dëshirueshëm.

Aktualisht nuk ka pasur ulje apo deformime të kurorës së digës apo shpateve të saj. Kjo gjëndje pasqyrohet dhe në skarpatat e sipërme e të poshtme të digës.

Vepra e marrjes është në funksion të plotë dhe brenda kushteve teknike të shfrytëzimit, si ana ndërtimore ashtu dhe ajo e paisjeve elektromekanike të saj. Po kështu galeria e kontrollit si dhe sistemet e shkarkimit janë në gjëndje të mirë teknike.

Si përfundim për digën e Komanit duam të theksojmë se pavarësisht nga investimet e tjera, analiza e filtrimeve në anën e poshtme të kësaj dige do duhet të jetë në krye të aktiviteteve studiuase e investuese për HEC-in e Komanit. Me punimet e rehabilitimit të anës së poshtme do të kemi dhe një mundësi vrojtimi me të saktë dhe në kohë të filtrimeve në anën e poshtme të digës së Komanit.

Në digën e Komanit duam të theksojmë se analiza e filtrimeve në anën e poshtme të kësaj dige do duhet të jetë në krye të aktiviteteve studjuse e investuese për HEC-in e Komanit.

Digat e HEC-it të Vaut të Dejës.

Për krijimin e liqenit të HEC Vau i Dejës janë ndërtuar 4 diga që janë diga e Qyrsaqit, Zadejes, Rragamit dhe Gjocaj. Tre të parat që administrohen nga KESH sh.a janë diga të mëdha ndërsa diga e Gjocajt më lartësi 12 m është administruar nga Ministria e Bujqësisë. Nga kjo digë merren afro $2 \text{ m}^3/\text{sek}$ për vaditjen e zonës së mbishkodrës.

Digat e HEC Vau i Dejës që administrohen nga KESH sh.a janë relativisht në gjëndje të mirë dhe brenda normave të sigurisë të parashikuara në standartet teknike dhe në rekomandimet e ICOLD. Këto diga kanë përfunduar së ndërtuari në vitin 1972.

Diga e Qyrsaqit me lartësi 46 m, është diga kryesore e kësaj nyje. Si kjo digë ashtu dhe ajo e Zadejes kanë funksionuar normalisht dhe nga vrojtimet rezulton se nuk ka probleme lidhur me sigurinë e tyre. KESH-sh a ka monitoruar me kompetencë sjelljen e këtyre digave në të gjitha aspektet e tyre. Me problematikja ka qenë diga e Rragamit me fenomenin e filtrimeve në trupin e saj. Gjatë vitit 2016 u hartua një projekt për të stabilizuar rrjedhjet dhe matjen e filtrimeve dhe për të rritur mundësitë e monitorimit me të saktë të saj. Nga KKDM është rekomanduar që ky projekt të plotësohet nga KESH-sh a, do të vazhdojë rishikimin dhe zbatimin e këtij projekti dhe marrjen e masave të tjera të nevojshme në të ardhmen.

Në nyjen e HEC-it të Vaut të Dejës, gjatë vitit 2016 janë ndërmarrë dhe disa projekte të tjera të financuara nga vetë përdoruesi. Ndër to mund të përmendim

sistemimin e zonës në dalje të tunelit të shkarkimit të Zadejës si dhe mbrojtjen dhe sistemimin e zonës së poshtme të digës së Qyrsaqit.

Në vecanti për punën e KESH-sh a lidhur me kaskadën e veprave në lumin Drin, duhet të theksojmë se më në fund kemi miratuar në KKDM, studimet e përhapjes së valës në raste të ndryshme në kaskadë dhe shtrirjen në kohë e thellësi në zonën poshtë Vaut të Dejës. Me hartimin e këtyre studimeve ka filluar punë KESH-i në bashkëpunim me Drejtorinë e Emergjencave dhe pushtetin vendor, për hartimin e Planit të Alarmit dhe Evakuimit. Ky është një hap cilësor i cili pavarësisht edhe ndonjë mangësie që mund të evidentohet në të ardhmen, përbën një plotësim të domosdoshëm në zbatim të legjislacionit për sigurinë e digave në vend. KKDM, vazhdimisht dhe në cdo rast ka kërkuar nga të gjithë pronarët që të plotësojnë planet e alarmit dhe evakuimit për cdo digë.

KESH sha, ka një përvojë të mirë në monitorimin e digave dhe duhet thënë se nuk ka qenë në vështirsinë e subjekteve të tjera pronare apo shfrytëzuese lidhur me mjetet financiare për të mundësuar investimet për rritjen e sigurisë së digave në administrim.

Digat në administrim nga shoqëria KURUM International sha.

Kjo shoqëri administron digat e HEC-ve të Ulzës, Shkopetit dhe Bistricës. Këto diga janë ndërtuar në vitet 60 të shekullit të kaluar dhe prej disa vitesh kanë kaluar në pronësi të privatit.

Materialet e mëparshme të vrojtimit të tyre administrohen nga KESH sh a, ndërsa aktualisht është njësi e drejtimit teknik të kompanisë që merret me monitorimin e gjëndjes së tyre. Simbas të gjitha matjeve dhe interpretimit të tyre, Shoqëria KURUM International sh a, raporton se nuk ka problem as të spostimeve në digat e betonit (Ulzë, Shkopet) dhe as në drejtim të filtrimeve. i vetmi problem që përmendet është ai i rehabilitimit të fugave midis blloqeve të betonit dhe vecanërisht në digën e Ulzës. Pavarësisht nga kjo, mbasi ato janë brënda limiteve të nevojshme, ky do jetë një problem që do kërkojë zgjidhje dhe investim në të ardhmen. Theksojmë se simbas raportit të njësisë teknike, monitorimi i digës kryhet me rregull teknik si ai visual dhe ai me aparatura.

Diga e HEC-it Banjë, administruar nga DEVOLL-Hydropower sh a.

Kjo digë filloi të vihet në ngarkesë para një viti (15 Prill 2016) dhe për këtë arsye po japim disa të dhëna më të detajuara.

Diga, e tipit me bërthamë argjili, ka një lartësi maksimale prej 85m dhe krijon një rezervuar me volum 213 mil.m³. Gjatë mbushjes, niveli maksimal në kuotën 175.69m u arrit për herë të parë në datë 17.11.2016. Hidrocentrali i Banjës është në pronësi të shoqërisë Devoll Hydropower sh.a. Operimi dhe monitorimi realizohen konform rregulloreve të operimit dhe mirëmbajtjes të Statkraftit. Uji ekologjik shkarkohet ose nga një turbinë e vogël me kapacitet 7MW, ose nga një ndarje e vecantë e vendosur në portat e mëdhaja të shkarkimit të plotave të vendosura në krahun e djathtë të digës. Monitorimi i digës me instrumentimin e instaluar, deri tani, kanë treguar rezultate të pritshme të parashikuara në projekt. Monitorimi me të gjitha mënyrat nuk kanë dhënë asnjë provë paqëndrueshmërie apo ndonjë rreziku tjetër që do të cenonin qëndrueshmërinë e digës dhe të veprave ndihmëse gjatë procesit të mbushjes apo gjatë vitit të parë të saj. Si dhe është e njohur, disa të dhëna duan me shumë kohë për të ndërtuar një vijueshmëri të fenomeneve dhe që do krijojnë një siguri të mëtijshme për strukturat. Pritshmëria është se nuk do ketë devijime mbasi cdo gjë ka qenë normale dhe duke mos pasur asnjë devijim nuk ka qenë e nevojshme për monitorime shtesë jashtë atyre të parashikuara.

Nga vrojtimet e deritanishme ka rezultuar se në brigjet e kupës së rezervuarit ka patur rrëshqitje të shpateve të cilat duhet të mbahen në vërejtje.

Mirëmbajtja e objektit është parashikuar në tre lloje: mirëmbajtje rutine; parandaluese dhe simbas ngjarjeve të vecanta. Aktualisht jemi brenda normalitetit.

Inspektimi do jetë javor; periodik- cdo gjashtë muaj dhe ai i posacëm i cili do të kryhet mbas ngjarjeve të pazakonta.

Të gjitha matjet futen në programin kompjuterik për bërjen e vlerësimit të gjëndjes.

KONKLUZIONE TE PERGJITHESHME.

Në këtë përmbledhje jemi munduar që të paraqesim problematikën e mbledhur në këto dy vjet 2015-2016, lidhur me realizimin e kërkesave për realizimin e sigurisë së digave, konform legjislacionit që kemi.

1. Nga 61 bashki vetem 37 prej tyre kanë dërguar raportin vjetor për gjëndjen e digave që ato kanë në pronësi e përdorim. Kjo pavarësisht kujtesës për zbatimin e informimit ligjor të bërë prezent bashkive që në fillim të muajit Janar 2017 nga ana e KKDM-së. Procedura e kalimit të pronësisë nga MBZHRAU në bashkitë filloi mbas VKM nr. 1108 dt. 30.12.2015. Bashkëlidhur është lista e bashkive që nuk kanë dërguar raportin vjetor, për vitin 2016.
2. Në këto dy vite (dhe jo vetëm), ka munguar struktura e Inspektoriatit Teknik të Digave (ITD) e cila është pjesë e SKDM-së. Kjo strukturë është ajo e cila me ligj ka të drejtën e vendosjes së sanksioneve ndaj subjekteve që shkelin ose nuk zbatojnë ligjshmërinë për digat.
Jemi të mendimit se ky inspektoriat do duhet të fillojë nga funksionimi sa me parë qoftë dhe me një strukturë të vogël prej dy specialistësh me eksperiencë (përvojë). KKDM i drejtohet Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë Transportit dhe Infrastrukturës që të realizojnë plotësimin e kësaj strukture të Sekretariatit Kombëtar të Digave të Mëdha, pranë MTT-së.
3. KKDM i ka rekomanduar Sekretariatit Kombëtar të Digave të Mëdha për krijimin e një regjistri të ri të digave dhe të njësive të drejtimit teknik, mbas ndryshimeve të ardhura nga transferimi i pronësisë nga MBZHRAU në Bashkitë. Në këtë regjistër do duhet të pasqyrohen jo vetëm digat dhe gjëndja e tyre por dhe specialistët përgjegjës për cdo digë, në kuptimin e kontrollit teknik mbi to.
4. Problem aktual është studimi dhe hartimi i masave për sigurinë e digës së Liqenit Artificial të Tiranës. KKDM ka ushtruar kontroll në Bashkinë e Tiranës në vitin 2015. Ka kërkuar zyrtarisht në këtë vit dhe gjatë vitit 2016 që të studiohet gjëndja e digës së Liqenit Artificial dhe anekseve të saj. Kemi theksuar se diga në kushtet e gjëndjes së bllokimit që ka të shkarkuesit fundor, qysh prej vitit 2002, nuk mund të jetë e sigurtë në rast aktivizimi të

ndonjë rreshqitje të konsiderueshme ose rreshje atmosferike të mëdha. Pamundesia e uljes së nivelit të ujit të liqenit, mund të përbëjë një rrezik serioz për popullsinë dhe ekonomine poshtë digës. Bashkia e Tiranës do duhet të investojë që të mos jetë e detyruar me vonë të shpenzojë pa masë duke dëmshpërblyer të tretët dhe mbi të gjitha pasojave morale. Gjithashtu kemi kërkuar bërjen e studimit të përhapjes së valës për rezervuarin e Bovillës dhe të Liqenit Artificial të Tiranës dhe në vazhdim dhe planet e alarmit dhe evakuimit. Shoqëria e Ujësjetës Kanalizimeve e Bashkisë Tiranë e cila është përgjegjëse dhe përdoruese e këtyre digave nuk ka treguar impenjimin e duhur për realizimin e tyre. KKDM do vazhdojë të tërheqë vëmendjen e gjithë organeve të interesuara për këtë problem.

5. KKDM ka këmbengulur në këto dy vite për realizimin e një Programi Kombëtar për kontrollin dhe evidentimin e gjëndjes së digave. Jemi në pritje për ecurinë në rrethet Tiranë e Durrës dhe prandaj në këtë raport kemi propozuar dhe variantin e krijimit të një grupi specialistësh nga MBZHRAU të cilët kanë dhe përvojë të mëparëshme.
6. Theksojmë se KKDM e vetme dhe me gjithë impenjimin për kujtesën e detyrimeve ligjore që u bën subjekteve, kontrollin e projekteve, procedurat e kontrollit dhe dhënies së autorizimeve për mbushjen për herë të parë, seminareve që ka organizuar për sensibilizim, përsëri kjo është e pamjaftueshme pa një impenjim të madh të pronarëve e përdoruesve të tyre që janë organet e Bashkive.

Jemi të mendimit se kemi paraqitur në mënyrën më të mundshme, të përmbledhur, problematikat më kryesore të digave në vend.

Me respekt,

Inxh. Maksim Muçi

KRYETAR

